



MORRAT ?





SI T'I ZHDUKIM ME SUKSES!



Këshilla drejtuar prindërve



Udhëzime të reja

-  I kërkojmë morrat dhe thërijat
-  Po qe se i shohim i trajtojmë 3 herë
-  Çdo anëtarë i afërt i familjes kontrollohet
-  Fëmija mund të shkojë normalisht në shkollë



Historia e morrave !



Morrat janë shumë të pakëndëshme dhe më shpejt merren se sa zhduken. Që prej shumë kohësh këta parazitë jetojnë në mes njerëzve dhe ne kemi qenë të detyruar të bashkëjetojmë. Çdo njëri thotë : « Jo në kokën time ! »

Paraqitja e morrave s'është shenjë e mungesës së higjenës..

Morri ushqehet me gjakun e njeriut. Ai vdes brenda 48 orësh jashtë kokës.

Ai përhapet përmes kontaktit të drejtëpërdrejtë kokë më kokë.

Ai lëviz shpejt, ikën nga drita, ngjitet për flokësh, nuk kërcen, nuk fluturon dhe mbijeton vetëm 10 minuta mbi sipërfaqe të ujit.

E shohim veçanërisht rreth tëmthave të kokës, prapa veshëve dhe mbi qafë.

Kur duhet t'i kërkojmë ?

Fëmija kontrollohet po qe se kruhet në kokë ose po qe se dëgjoni se morra ka në shkollë, në familje ose te miqtë.



Si t'i kërkojmë ?

Thërijat ngjiten në flokë, ndërsa zbokthi shkëputet lehtë nga flokët. Kontrolloni flokët sipas mënyrës që vijon :

Flokët lahen me shampo të zakonshëm dhe shpërlahen

- 🪲 Shpatullat mbulohen me një peshqir të bardhë.
- 🪲 Flokët i krehim dhe i ndajë cullufe, cullufe.
- 🪲 Flokët i krehim me një krehër kundër morrave duke e tërhequr atë nga lëkura e kokës deri në fund të flokëve.
- 🪲 Pas çdo të krehuri, krehërin e pastrojmë mbi peshqir dhe verifikojmë po qe se ka morra.



Keni gjetur morra ose thërija të posalindura



- ✈ Faleminderit që informoni mësuesin (mësuesen), infirmieren e shkollës ose çerdhen jashtëshkollore.
- ✈ Bleni një ilaç kundër morrave në farmaci. Ekzistojnë dy grupe të ilaçeve që janë efikase kundër morrave :
 - ✈ Shampo që përbën vaj silikoni
 - ✈ Shampo që përbën insekticide

3 përdorime të vazhdueshme janë të domosdoshme : ditën e parë, të tetë dhe të pesëmbëdhjetë.

Përdoroni ilaçin sipas udhëzimeve të dhëna, lini një kohë të gjatë ose së paku **20 minuta të veprojnë**, kjo vlen për insekticidet, ndërsa ilaçin me vaj silikoni e lini **tërë natën** !



Vemendjen përqëndroni te koka dhe jo te ambienti ku jetoni. Lani me 60° çarshafët e dyshekut, jorganit, jastikut dhe pellushet dhe ato duhen ndërruar çdo dy ditë.

Zhdukni të gjitha thërijat ! Kjo është menyuja e vetme për t'i shporrë definitivisht morrat. Për t'ia arritur këtij qëllimi, përdorëni krehërin e posaçëm ose hiqni me dorë ! (një nga një me majet e thonjëve). Këto veprime duhen përsëritur çdo ditë, pa humbur durimin brenda dy javësh dhe kjo është pjesa me e rëndësishme e gjithë trajtimit !



Mos përdorëni krehëra dhe furçe flokësh që bartin morra. Krehërat i lani me ujë të ngrohët (lini 10 minuta në ujë). Po qe se keni flokë të gjata duhet t'i lidhni. Trajtimet preventive janë të panevojshme, rëndësi ka kujdesi dhe kontrollimi i vazhdueshëm.

Morri i kokës

- ✂ Është insekt i përhimtë i gjatë afërsisht 2-3 mm.
- ✂ Ai nuk është ngjitës i sëmundjeve
- ✂ Ai nuk jeton mbi kafshët shtëpijake
- ✂ I reziston shampove të zakonshëm



Morri


🐛 Shtati i zakonshëm i morrit



Thërijat

Cikli i jetës së morrit

- ✂ Ai bën 7 deri 10 vezë (thërija) në ditë brenda një harku kohor 11 deri në 15 ditë radhazi.
- ✂ Thërijat i ngjajnë zbokthit që shkëlqen dhe me shumë vështirësi hiqen.
- ✂ Ata që jetojnë gjenden 1 deri 4 mm nga lëkura e kokës.
- ✂ Pas 7 ose 10 ditësh morrat e rinj lindin.
- ✂ Në vazhdim pas 7 ose 10 ditësh, ata bëhen të rritur dhe janë të gatshëm për të riprodhuar.
- ✂ Një morr jeton afërsisht 4 javë nga momenti që del nga veza



Ju falemnderojmë për bashkëpunimin tuaj !



Schulleitung ABGRU

Ilustrimet janë marrë : Google pamje